

## **HYRJE**

Fushat teknologjike janë fusha në të cilat pritet që nxënësit të bëjnë aktivitetet e tyre teknologjike dhe të cilat përbëjnë kornizën e kurrikulit që do të organizohet dhe zhvillohet në shkolla. Renditja e fushave është e rastit dhe nuk paraqet rëndësinë e tyre.

Puna e dorës për klasën e parë ka të bëjë me përvetësimin e njohurive dhe shkathtësive të nevojshme (Materialet dhe përpunimet e tyre, pajisjet teknike, trafiku, mjedisi, shëndeti dhe siguria) që parashihen për këtë nivel.

Lënda e punës së dorës ndihmon në zhvillimin e gjithanshëm të nxënësve, duke zhvilluar aftësinë e tyre krijuese si dhe ato komunikuese. Lënda ndihmon në formimin dhe në zhvillimin e koncepteve, si në punën e dorës, ashtu edhe në lëndë të tjera mësimore që zhvillohen në shkollë.

## **QËLLIMET**

Qëllimet kryesore të punës së dorës të nxënësit janë:

- Zhvillimi i një shprehje pozitive të nxënësit ndaj shprehisë në punë dore dhe rëndësisë së saj.
- Familjarizimi me mjedisin dhe motivimi i nxënësve që njohuritë e nxëna t'i shfrytëzojnë në jetë.
- Inkurajimi i nxënësve për të marrë ndonjë nismatë dhe veprim të pavarur, duke patur parasysh rregullat themelore të sjelljes në grupe, në vartësi nga llojet e ndryshme të veprimtarive që zhvillojnë.

## OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Nxënësi duhet:

### Të zhvillojë qëndrimet dhe vlerat

- Në kuptimin e përparësive dhe kufizimeve që i ofron lënda.
- Në kuptimin e sjelljeve personale (të jetë kooperativ, i hapur, tolerant, i ndershëm, i vullnetshëm, kritik, me nisëtiavë, etj.)

### Të kuptojë

- Rregullat e trafikut dhe të sigurisë.
- Faktorët që ndikojnë në ndotjen e mjedisit.
- Rregullat e higjienës.

### Të zbatojë

- Përpunimin e materialeve me vegla të thjeshta.
- Rregullat e trafikut në praktikë.
- Mirëmbajtjen e shëndetit.
- Ruajtjen e mjedisit.

### Të demonstrojë shkathhtësi mendore

- Në marrjen e vendimeve të logjikshme (duke i zgjedhur informacionet, njohuritë dhe përfundimet relevante).
- Të ketë besim në vetvete dhe të rrisin besimin në aftësinë e tyre për punë artizanale.

## ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES PROGRAMORE:

Kategoritë	Nënkategoritë	Nr. i orëve	Përqindja
<b>1. Materialet dhe përpunimet e tyre</b>		<b>8</b>	<b>44.4 %</b>
<b>2. Pajisjet teknike</b>		<b>4</b>	<b>22.3 %</b>
<b>3. Trafiku</b>		<b>2</b>	<b>11.1 %</b>
<b>4. Mjedisi</b>		<b>2</b>	<b>11.1 %</b>
<b>5. Shëndeti dhe siguria</b>		<b>2</b>	<b>11.1 %</b>

<b>KATEGORITË</b>	<b>NËNKATEGORITË</b>	<b>PËRMBAJTJA PROGRAMORE</b>	<b>REZULTATET E PRITSHME</b>	<b>LIDHJA NDËRLËNDORE</b>
<b>1. Materialet dhe përpunimet e tyre</b>	<b>1.1. Njohja dhe klasifikimi i materialeve</b>  <b>1.2. Puna me materiale dhe përdorimi i veglave</b>	1.1.1. Përdorimi i shqisave për të vëzhguar dhe njohur ngjashmëritë në mes të materialeve. 1.1.2. Klasifikimi i materialeve në grupe në bazë të vetive elementare (struktura, pamja, tejdukshmëria). 1.2.1. Puna me këto materiale: letër, plastelinë, argjilë, brumë, kit, rërë, shkopinj, kokrra gruri, misër, fasule, etj. 1.2.2. Përdorimi i gërshërëve. Ndryshimi i formës përmes palimit, prerjes, ngjitjes, lidhjes me kapëse, ndrydhjes.	Nxënësi duhet të jetë në gjendje: Të njohë vetitë elementare të materialeve nga jeta e përditshme dhe mënyrat e përpunimit të tyre. Të krahasojë vetitë me përdorim të materialit të veçantë.	Gjuha amtare Artet e bukura
<b>2. Pajisjet teknike</b>	<b>2.1. Veprimet me konstruksione</b>	2.1.1. Konstruksionet me elemente përbërëse.	Nxënësi duhet të jetë në gjendje: Të dijë të përdor teknikat e përpunimit dhe bashkimit të përshtatshëm për materialet që përdoren.	Gjuha amtare Matematika
		2.1.2. Konstruksionet nga materialet natyrore.	Të zhvillojë ide të qartë se çka duhet të bëjë.	
		2.1.3. Çmontimi i lodrave të cilat mund të çmontohen.	Të kuptojë dallimin në mes të tërësisë së objektit dhe të pjesëve përbërëse.	

<b>3. Trafiku</b>	<b>3.1. Shenjat e trafikut</b>	3.1.1. Njohja me rrugët përreth shkollës, cilat janë shenjat e shtigjeve për këmbësorë dhe çiklistë.	Nxënësi duhet të jetë në gjendje: Të dijë si të sillet me siguri prej shtëpisë në shkollë dhe anasjelltas.	Gjuha amtare
	<b>3.2. Rregullat e trafikut</b>	3.2.1. Nxënësit të njoftohen me rregullat në trafikun urban. 3.2.2. Kuptimi i rëndësisë i të qenurit të vërejtur si pjesëtar në trafik. 3.2.3. Njohja me rregullat e sjelljes si bashkudhëtar në mjetet e trafikut.	Të dijë si të sillet me siguri prej shtëpisë në shkollë dhe anasjelltas. Të sillet drejt në trafikun urban.	
<b>4. Mjedisi</b>	<b>4.1. Shprehitë e punës</b>  <b>4.2. Natyra që na rrethon</b>	4.1.1. Zhvillimi i shprehisë për përgatitjen e vendit të punës dhe pastaj vendosja e mbeturinave në vendin përkatës. 4.2.1. Njohja me shtazët dhe tokën e vendit. 4.2.2. Klasifikimi i natyrës së gjallë dhe jo të gjallë.	Nxënësi duhet të jetë në gjendje: Të dijë t'i përdorë në mënyrë të drejtë veglat për manipulim me letra.	Gjuha amtare
	<b>4.3. Të vërejturit e natyrës</b>	4.3.1. Të vërejturit dhe përshkrimi i dukurive të motit. 4.3.2. Të vërejturit dhe përshkrimi i aktivitetit të njerëzve dhe kafshëve gjatë ndryshimeve të motit.	Të dijë se me pastrimin e duarve dhe dhëmbëve zvogëlohet mundësia e infektimit nga sëmundjet e ndryshme dhe prania e gjallesave të vogla. Të dijë disa mjete higjienike të thjeshta dhe rregullat.	

<b>5. Shëndeti dhe siguria</b>	<b>5.1. Puna me vegla dhe mjete</b>	Manipulimi me disa vegla dhe mjete. Nxënësit të tregojnë mënyrat e ndotjes së duarve dhe të tregojnë për cilën arsye duhet pastruar ato.	Nxënësi duhet të jetë në gjendje: Të dijë t'i përdorë në mënyrë të drejtë veglat për manipulim me letra.	Gjuha amtare
	<b>5.2. Mjetet higjienike</b>	Përdorimi përkatës i mjeteve higjienike dhe preventive. Pastrimi i duarve pas punës.	Të dijë se me pastrimin e duarve dhe dhëmbëve zvogëlohet mundësia e infektimit nga sëmundjet e ndryshme dhe prania e gjallesave të vogla. Të dijë disa mjete higjienike të thjeshta dhe rregullat.	

## **VLERËSIMI**

Vlerësimi i të nxëniet bëhet në këto mënyra:

1. Vlerësimi i angazhimit të nxënësit gjatë realizimit të përmbajtjes programore
2. Vlerësimi i punës individuale
3. Vlerësimi i kontributit në punën grupore

## **UDHËZIME NË PËRDORIMIN E LITERATURËS DHE BURIMEVE TË TJERA MËSIMORE**

### **Literatura e propozuar**

1. Doracakë për mjedisin, trafikun, shëndetin etj.
2. **Erich Neuwirth**: “Spaß beim Forschen und Entdecken 1”, Veritas-Verlag, Linz, Austri, 2001.

### **Pajisjet dhe parakushtet e tjera të nevojshme**

1. Trajnime për arsimtarë
2. Kabineti i pajisur me materiale dhe mjete konkretizimi

### **Kushtet minimale**

1. Trajnime për arsimtarë

## **UDHËZIME METODOLOGJIKE TË PËRGJITHSHME**

1. Qasja problemore në paraqitjen e temës/njesisë
2. Theksi në demonstrim dhe punë individuale dhe grupore
3. Inkurajimi i punës individuale dhe shkëmbimit të dijes dhe të shkathtësive, puna interaktive

## **ORIENTIMET PËR PUNË TË PAVARUR**

1. Puna grupore dhe individuale